



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr.170 dt.06.11.1998

**“ANALIZA E PUNES SE SEKSIONIT ENERGJITIK GJATE VITIT 1998  
MBI NGROHJEN ME LENDE ENERGJITIKE TE POPULLATES,  
NDRICIMIN ELEKTRIK RRUGOR TE QYTETIT, MASAT PER DIMRIN  
1998 - 1999 DHE PERMIRESIMIN E NDRICIMIT RRUGOR”**

Këshilli Bashkiak i Tiranës, në mbledhjen e tij të dt.06.11.1998, pasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Përgjithshme të Punëve Publike dhe Shërbimeve. **“Analiza e punës së Seksionit Energjitik gjatë vitit 1998 mbi ngrohjen me lëndë energjitike të popullatës, ndriçimit elektrik rrugor të qytetit, masat për dimrin 1998 – 1999 dhe përmirësimin e ndriçimit rrugor”**, mbështetur në ligjin Nr.7572, dt.10.06.1992, **“Për organizimin dhe funksionimin e Pushtetit Lokal”**, si dhe në ligjin Nr.7582, dt.13.07.1992 **“Për Ndërmarrjet Shtetërore”** dhe Udhëzimin Nr.6, dt.03.02.1992

**VENDOSI**

1. Për të lehtësuar konditat e ngrohjes së popullatës për periudhën Nëntor 1998- Mars 1999 si dhe për situatën e vështirë të sistemit energjitik i sugjerojmë Qeverisë ulje çmimi të vajgurit në masën 50% e cila të subvencionohet po nga Qeveria. Afati i dërgimit 15 Nëntor 1998.
2. Për të përmirësuar studimet statistikore të konsumit të lëndëve energjitike për ngrohjen e qytetit, të detyrohen subjekte fizike dhe juridike (private dhe shtetërore) të sjellin të dhëna mujore

për shitjen e vazhdueshme të lëndëve energjitike që trajtojnë (në Seksionin Energjistik të Bashkisë).

Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Punëve Publike e Shërbimeve, Sektori i Statistikave.

3. Drejtoria e Urbanistikës të përshpejtojë aprovimin e shesheve për ndërtimin e kabinave elektrike dhe nënstacioneve të kërkuara nga K.E.SH.-i.

Afati në vazhdimësi.

4. Të kalojë aktiviteti i orëve nga Ndërmarrja e Dekorit në Ndërmarrjen e Ndrçimit Elektrik Publik, si ndërmarrje e specializuar për përmirësimin e gjendjes. Brenda muajit Nëntor 1998 të realizohet kalimi i të gjithë këtij aktiviteti nga Ndërmarrja e Dekorit në Ndërmarrjen e Ndrçimit Elektrik Publik.

5. Të bëhet studimi për të përmirësuar buxhetin e Ndërmarrjes së Ndrçimit Elektrik Publik (të financuar nga Bashkia) për punime ndriçimi në të tretë.

Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Punëve Publike e Shërbimeve.

Afati deri në 31.12.1998.

6. Për të përmirësuar më tej rrjetin e ndriçimit të rrugëve të akordohet një fond prej **7.010.000 lekësh** në zërin investime, për blerjen e pajisjeve dhe makinerive të mëposhtme :

<b>1.Autokulle</b>	<b>copë 1</b>	<b>4.500.000 lekë</b>
<b>2.Auoveturë</b>	<b>copë 1</b>	<b>650.000 lekë</b>
<b>3.Motosaldatriçe</b>	<b>copë 1</b>	<b>650.000 lekë</b>
<b>4.Matrapik</b>	<b>copë 1</b>	<b>160.000 lekë</b>
<b>5.Grup diezel</b>	<b>copë 1</b>	<b>700.000 lekë</b>
<b>6.Trapan dore</b>	<b>copë 4</b>	<b>80.000 lekë</b>
<b>7.Motosharre</b>	<b>copë 1</b>	<b>20.000 lekë</b>
<b>8.Mikrokompjuter</b>	<b>copë 1</b>	<b>250.000 lekë</b>

**GJITHSEJ 7.010.000 lekë.**

7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**ORHAN SAKIQI**